



VENDIM

Nr. 15 Datë 16.02.2016

PËR

LIÇENSIMIN E SHOQËRISË “PËRPARIMI SK” SH.P.K., NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “SHTIKA”

Në mbështetje të neneve 16, 37 gërma “a” dhe 110 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “a”; 5 pika 1 gërma “a”; 13 dhe 14 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 16.02.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “PËRPARIMI SK” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec Shtika të kësaj shoqërie, me fuqi totale 1300 KW,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “PËRPARIMI SK” sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1), është plotësuar në mënyre korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2), është plotësuar në mënyre korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3), është plotësuar në mënyre korrekte.
- Të dhëna specifike për Hec-in (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyre korrekte.

Për gjitha sa më sipër, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licensojë shoqërinë “PËRPARIMI SK” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “SHTIKA” me fuqi totale 1300 KW, për një afat 30-vjeçar.
2. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.